



Republika e Kosoves
Republican Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V-të

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 35/15

Prishtinë, më 24.11.2015, ora 14:00

Ndertesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Ne mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadergjonaj, Latif Gashi, Labinote Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Jelena Bontic dhe Fikrim Damka.

Munguan: Bardhyl Meta, Ilir Deda, Enver Hoti dhe Bali Muharremaj.

Pjesëmarrës të ftuar: Avdullah Hoti – Minister i Financave, Agim Krasniqi- Zevendes Minister i Financave, Salvador Emlazi- Drejtor i Buxhetit.

Gjithashtu të pranishëm ishin: Fjolla Uka – monitoruese nga KDI, Lumnije Murati – nga Zyra e Presidencës dhe Rejhane Zylfaj - nga GIZ.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljeta Krasniqi, Dashurije Canolli, Medina Agushi (praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetari i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, datë 18.11.2015;
3. Shqyrtimi i Projektligjit (pjesa tekstuale) për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjen për Hua ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin e Rehabilitimit të Rrugës Hekurudhore 10;
5. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjen për Hua ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për Bashkëpunim Financiar 2014 për Projektin e Huasë;
6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-41 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin të funksionit publik, dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit;
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari - propozoj që të bëhet renditja e pikave të rendit të ditës që pika 4 dhe 5 të bëhen pika 3 dhe 4 dhe pika 3 të kaloj si pika e 5-të.

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi propozimin për rirenditjen e pikave të rendit të ditës dhe si rrjedhojë pika 4 dhe 5 të bëhen pika 3 dhe 4 dhe pika 3 të kaloj si pika e 5-të.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, datë 25.11.2015

Kryetari - konstatoi se procesverbali miratohet pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjen për Hua ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin e Rehabilitimit të Rrugës Hekurudhore 10

Avdullah Hoti - Qeveria e Kosovës për financimin e projektit të rehabilitimit të rrugës hekurudhore 10 i cili parashihet të kushtoj rreth 195,5 milion euro, përfshirë këtu edhe të gjitha taksat. Ne kemi identifikuar burimet e financimin dhe deri me tani kemi nënshkruar marrëveshjen për kredi financim me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim me shumën prej 39,9 milion euro. Kushtet e kesaj kredie janë mjaftë të volitshme, me njëzet e dy këste gjysëm vjeçare me normë interesit prej 1%. Kjo kosto është mjaftë e përbalueshme. Është projekt i rëndësishëm pasi që funksionalizon rrjetin e hekurudhave. Me ratifikimin e kësaj, po ashtu mudesojmë marrëveshjen tjetër edhe me Bankën Evropiane për Investime në vlerë prej 4 milion euro për këtë projekt.

Kryetari - me këtë hua a ngarkohet buxheti i Kosovës?

Avdullah Hoti – kjo kredi nënshkruhet tek ndërmarrja publike Infrakos. Pra buxheti i Kosovës nuk ngarkohet drejtpërdrejtë. Garancioni që ne e lëshojmë janë pjesë e borxhit publik, duke qenë se grejs periudha është katër vite, projekti kryhet dhe pastaj ndërmarrja publike fillon ta kthejë këtë kredi. Po ashtu është duke investuar në të njejtën kohë në ngritjen e kapaciteteve menaxhuese të ndërmarrjes në mënyrë që kur të implementohet projekti të merret kjo mundësi. Pra këto janë parashikimet, normalisht Qeveria e Kosovës është garantues nëse ndërmarrja nuk arrin ta kthejë. Pjesë e marrëveshjes është edhe krijimi i njësisë për menaxhim të projektit nga BERZH-i në ndërmarrjen publike.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë rekomandim

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjen për Hua ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin e Rehabilitimit të Rrugës Hekurudhore 10.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjen ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për Bashkëpunim Financiar 2014 për Projektin e Huasë

Avdullah Hoti - Ministria e Financave në shtator të këtij viti ka nënshkruar marrëveshjen me Qeverinë Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar në pjesën e kredisë për vitin 2014 dhe kjo është bërë këtë vit për shkak të vonesave që janë bërë vitin e kaluar. Marrëveshja për vitin 2014 shkon ndaras për kredi dhe për grant. Ky projektligj përfshin këtë kredi me KfW për projektin Mbeshtetja e Sektorit në

fazën e tetë përmirësimi i rrjetit në vlerë prej 12 milion euro që i nënhezohet ndërmarrjes KOSTT. Kushtet e kredise janë shumë të volitshme dhe nuk paraqet ngarkesë për buxhetin e Kosovës.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë rekomandim

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për Bashkëpunim Financiar 2014 për Projektin e Huasë.

5. Shqyrtimi i Projektligjit (pjesa tekstuale) për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016

Agim Krasniqi – propozojë që në pjesën tekstuale të Projektligjit për Buxhetin 2015, të bëhen disa ndryshime, si në vijim:

Në nenin 6, paragrafi 7 të riformulohet si në vijim:

7. Pavaresisht nga paragrafet 3 dhe 4 të këtij neni, Agjencia Kosovare e Privatizimit në pajtim me Ligjin Nr.04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe Agjencinë Kosovare për Shërbimet e Navigacionit Ajror në pajtim me Ligjin Nr.04/L-250 për Agjencinë e Shërbimit të Navigacionit Ajror, për vitin 2016 do të financohen tërësisht nga të hyrat e dedikuara dhe të depozituara në Fondin e Kosovës sipas tabelës 3.1.A të bashkangjitur me këtë ligj. Fondet e mbetura nga çdo të hyrat e dedikuara e të pashpenzuara nga viti paraprak vazhdojnë të trajtohen si të hyra të dedikuara për financim të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Agjencisë për Shërbimet e Navigacionit Ajror, për vitet vijuese.

Në nenin 6, pas paragrafit 7, të shtohet një paragraf i ri 8, me tekstin si në vijim:

8. Të gjitha mjetet e pashfrytëzuara deri më 31.12.2015, Agjencia për Shërbimet e Navigacionit Ajror, nga llogaria e tanishme të bartë në Fondin e Kosovës, në llogarinë zyrtare të hapur nga Thesari, Ministria e Financave për këtë Agjenci.

Në nenin 9, pas paragrafit 4, të shtohen dy paragrafe të reja 5 dhe 6, me tekstin si në vijim:

5. Në rast se gjatë vitit fiskal shumat e Fondit Zhvillimor të Mirëbesimit që janë të depozituar në Fondin e Republikës së Kosovës dhe të regjistruara në SIMFK, tejkalojnë shumën e ndarjeve buxhetore sipas tabelës 3.1., nënprogrami Thesari, kategoria kapitalet, me vendim të Ministrit këto mjete regjistrohen si bilanc në dispozicion për Fondin Zhvillimor të Mirëbesimit. Ministri i Financave në Raportin vjetor financiar në mënyrë specifike raporton për ndarjen dhe mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve për Fondin Zhvillimor të Mirëbesimit.

6. Për periudhën Janar-Qershor të vitit 2016, Radiotelevizionit të Kosovës, i ndahet një shumë prej 4,800,000 euro, në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere. Para secilit tremujor, RTK do të dorëzojë në Kuvendin e Kosovës, programin e shpezimeve të planifikuara. Në fund të çdo tremujor, RTK do të dorëzojë në Kuvendin e Kosovës, raportin për shpenzimet e bëra.

Në nenin 13, në paragrafin 4, në rreshtin e parë, referenca “paragrafi 1”, bëhet referenca “paragrafi 2”

Kryetari konstatoi se komisioni njëzëri miratoi ndryshimet në tekstin e Projektbuxhetit 2016 sipas propozimeve të Ministrisë së Financave, të paraqitura nga zëvendës-ministri i financave z. Agim Krasniqi, me tekstin e lartpërmendur.

Kryetari – propozojë që në nenin 16, në paragrafin 5, në rreshtin e parë, fjalët “iniciativë ligjore”, zëvendësohen me fjalën “projektligj”

Komisioni njëzëri miratoi ndryshimin në nenin 16, paragrafi 5, ku në rreshtin e parë fjalët “iniciativë ligjore”, zëvendësohen me fjalën “projektligj”

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr.05/L-41 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin të funksionit publik, dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit

Kryetari – theksoi në bazë të analizës së bërë projektligjit dhe duke marrë për bazë opinionin e departamentit të buxhetit të Ministrisë së Financave, shifet se projektligji nuk përmban kosto shtesë buxhetore. Po ashtu edhe amendamentet e komisionit funksional, nuk përmbajnë kosto shtesë buxhetore.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

1. Projektligji Nr.05/L-41 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin të funksionit publik nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit për Projektligj Nr.05/L-41 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin të funksionit publik nuk përmban implikime buxhetore shtesë.

7. Të ndryshme

7.1.Shqyrtimi i Kërkesës së Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike (ARKEP) dhe Postare për realokime buxhetore nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime në kategorinë paga dhe mëditje

Kryetari – njoftoi anëtarët e Komisionit se ARKEP i ka drejtuar një kërkesë komisionit, që kërkon transferin e mjeteve në vlerë prej 30,000 euro, nga kategoria mallra dhe shërbime në kategorinë paga dhe mëditje. Arsyetimet janë dhënë për punën e madhe dhe angazhimin e shtuar të ekspertëve të ARKEP-it me pune intenzive në rastin e hartimit të metodologjisë së vlerësimit të aspekteve frekuencore dhe administrimin e gjithë procesit kompleks. Paragrafi 4 i nenit 13 të Ligjit për Buxhetin të Republikës së Kosovës, parasheh se në çdo rast kur kërkohet transferi i mjeteve nga ndonjë kategori ekonomike në kategorinë paga dhe mëditje, duhet aprovim paraprak nga ana e Kuvendit.

Safete Hadergjonaj - nuk pajtohem që këtë kërkesë ta procedojmë më tutje në Kuvend sepse proceduralisht nuk mundemi. Kërkesa është mjaft e paarsyeshme dhe kërkesa të këtilla kemi nga shumë institucione që mjetet të cilat u janë tepruar duan që ti shfrytëzojnë si mëditje për të punësuarit. Nëse i analizojmë pagat dhe mëditjet e këtij agjensionit dalin si pagat dhe mëditjet më të mëdha krahasuar me të gjitha institucionet dhe agjensionet e pavarura të cilat veprojnë si organizata buxhetore të pavarura. Prandaj nuk pajtohem që të përkrahim këtë kërkesë dhe si e tillë paarsyetuar në mënyrë të duhur, sepse duhet të dijme nëse është shtuar numri i të punësuarve, sa ekspert kanë punuar dhe sa paguhen këta ekspert. Pra kërkesa është dashur të jetë e arsyetuar në mënyrë më të detajizuar.

Besa Gaxheri - nuk pajtohem me arsyeshmërinë e kërkesës dhe mendojë nuk duhet ta dërgojmë më tutje këtë çështje.

Agim Krasniqi - unë mendojë që ju si komision mundeni të thoni si në këtë rast apo edhe në raste tjera të ngjashme të zbatohen procedurat ligjore që rregullojnë këtë çështje. Nëse ndokush ka punuar më shumë orë apo jashtë orarit të punës janë ligjet dhe aktet nënligjore që e rregullojnë çështjen e kompenzimit.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

Komisioni nuk përkrahu Kërkesën e Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për realokime buxhetore nga kategoria ekonomike mallra dhe shërbime në kategorinë paga dhe mëditje.

7.2 Shqyrtimi i Projektligjit për Energjinë Termike dhe amendamenteve të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Kryetari – theksoi në bazë të analizës së bërë projektligjit dhe duke marrë për bazë opinionin e departamentit të buxhetit të Ministrisë së Financave, shifet se projektligji nuk përmban kosto shtesë buxhetore. Po ashtu edhe amendamentet e komisionit funksional, nuk përmbajnë kosto shtesë buxhetore.

Pas diskutimeve dhe sqarimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë

Rekomandim

1. Projektligji për Energjinë Termike, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisioni Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri për Projektligjit për Energjinë Termike, nuk përmban implikime buxhetore shtesë.

Mbledhja përfundoi në ora 15:30

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani